- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoffimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

Numri i Prokurimit 652-23-4339-5-2-1-“ Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjes në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jete të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues,

Numri i Prokurimit 652-23-4339-5-2-1-“ Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjetësve në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik

duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitivave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paguesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

Numri i Prokurimit 652-23-4339-5-2-1-“ Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjes në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “Force Madhore” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit 39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejtë që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin

Numri i Prokurimit 652-23-4339-5-2-1-“ Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellësve në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik

mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e Vleres së Kontratës apo 14,494.16€
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>

Numri i Prokurimit 652-23-4339-5-2-1-“ Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjes në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 26.06.2023 ku i gjith plani dinamik aratohet në ditar ndërtimor.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 70 ditë pune.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Hajredin Shehu
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: 10% e vlerës së Kontratës
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është:
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 pesë ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365+30 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen].
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetent në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo

PARAMASA E
PUNËVE PËR NDËRTIMIN E REZERVUARIT AKUMULUES ME STACION POMPIMI DHE KAPTAZHËS NË FSH. BAJNICË

A/. RREJTI I UJËSJELLËSIT - BAJNICË

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
<i>PUNIMET NË SHTRATIN E PËRROIT</i>					
PUNËT E TOKËSORE - GERMIMIT					
1	Prerja, pastrimi dhe largimi i drunjëve në hapsirën ku do të punohet shtrati i ri i përroit. Në llogari hynë edhe largimi i materialit në deponinë e caktuar nga organi mbikqyres. Llogaria të bëhet për m ² .	m ²	440.00	0.90	396.00 €
2	Gërmimi i dheut të kat. së IV-të, V-të dhe formacioneve shkëmbore me makineri adekuate në hapsirën ku do të punohet shtrati i prorit duke ju përshtatur pjertësis dhe kushteve të terrenit. Gjatë gërmimit ti jipet forma e prerjes terthore sipas detalit të treguar. Llogaria të bëhet për m ³ të dheut dhe formacioneve të gërmuara.	m ³	1782.00	1.20	2,138.40 €
3	Sigurimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së zhavorit të pasëperuar me formacion 0-31.5 mm me trashësi d=15 cm në gjendje të ngjeshur në profilin e ri të shtratit. Llogaria të bëhet për m ³ të zhavorit të punuar.	m ³	66.00	9.00	594.00 €
4	Sigurimi, transporti dhe montimi i gurëve të klasës së I-rë të cilët i plotësojnë kushtet për shtrimin e shtretërve me trashësi mesatare d=25 cm. Në llogari hynë edhe punimi i fugave me llaq të qimentos. Llogaria të bëhet për m ² të shtratit të punuar.	m ²	440.00	10.00	4,400.00 €
5	Sigurimi i materialit për punimin e mureve dhe themeleve të kaskadave (3 copa) në shtratin e përroit nga materiali BA-së me beton të klasës C -25/30 Mpa dhe armaturës B 500 Mpa. Punimi i kaskadave të bëhet në shtratin e përroit në tërë profilin tërthor. Trashësia e murit të kaskadave janë b= 30 cm ndërsa lartësia hmes.= 1.0m . Armimi të bëhet sipas vizatimit të treguar. Në llogari hynë të gjitha nënpozicionet tjera për kompletim të pozicionit. Llogaria të bëhet për m ³ të BA-së të hudhur në vepër.	m ³	9.50	85.00	807.50 €
6	Sigurimi i materialit për punimin e mbikalimit të përroit nga materiali BA-së me beton të klasës C -25/30 Mpa dhe armaturës B 500 Mpa. Punimi i mbikalimit (urës) të bëhet mbi shtratin e përroit të punuar. Dimensionet e mbikalimit a x b= 5.0*2.5 m me trashësi të pllakës d=30 cm. Armimi të bëhet sipas vizatimit të treguar. Në llogari hynë të gjitha nënpozicionet tjera për kompletim të pozicionit. Llogaria të bëhet për m ³ të BA-së të hudhur në vepër.	m ³	3.75	85.00	318.75 €
Gjithësej I:					8,654.65 €

PUNIMET E KAPTZHËS

II	PUNIMET E KAPTZHËS				
1	<p>Sigurimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së argjilës së kl. së I-rë me dorë me trashësi 25 cm në gjendje të ngjeshur në mënyrë që të fitohet shtresa ujëmbajtëse. Kujdes të veçantë shtesës ujëmbajtëse të ipet pjesës fundore në mënyrë që mos të largohet uji.</p> <p>Llogari bëhet për m³ të argjillës së punuar.</p>	m ³	23.00	6.00	138.00 €
2	<p>Largimi i ujrave me anë të pompës gjatë zhvillimit të punimeve në hapsirën e kaptazhës.</p> <p>Llogaria bëhet për orë efektive të pompës</p>	orë	10.00	1.30	13.00 €
3	<p>Mbulimi i hapsirës së kaptazhës (me kujdes) me dorë me material të zhavorit të lumejve me njëfraksion 63 mm deri në nivelin e burimit të ujit min 50 cm duke mos e dëmtuar gypin e montuar më parë.</p> <p>Llogaria bëhet për m³ të zhavorit të punuar.</p>	m ³	20.00	9.00	180.00 €
4	<p>Sigurimi dhe montimi i shtresës së gjeotekstil dhe folisë PVC në hapsirën akumuluese të kaptazhës.</p> <p>Llogaria bëhet për m².</p>	m ²	50.00	1.60	80.00 €
5	<p>Sigurimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së argjilës së kl. së I-rë me dorë me trashësi 50 cm në gjendje të ngjeshur pas montimit të gypit dhe shtresave të zhavorit.</p> <p>Llogari bëhet për m³ të argjillës së punuar.</p>	m ³	8.00	9.00	72.00 €
6	<p>Mbulimi i hapsirës së kaptazhës me zhavor të seperuar të lumejve ose zhavorit (me shtresa) më parë të gërmuar deri në nivelin e terrenit duke bërë largimin e gurëve të medhej.</p> <p>Llogaria të bëhet për m³.</p>	m ³	15.00	11.00	165.00 €
7	<p>Sigurimi, transporti dhe punimi i rrethojës së hapsirës së kaptazhës me tela me gjemba në 5 (pesë) rende. Telat me gjemba të përforcohen në shtyllat e profileve të petëzuara të qelikut "□" 60*60*3mm me lartësi të shtyllave min 2.0m mbi nivelin e terrenit. Profilet e petëzuara betonohen në bazën e betonit. Distanca e shtyllave të jetë max. 2.0m. Në llogari hynë edhe punimi i derës me profile të petëzuara sipas normave dhe kushteve standarte si dhe ljerja e shtyllave dhe profileve me ngjyrë bazë dhe ngjyrë të yndyrshme sipas normave dhe kushteve ndërtimore .</p> <p>Llogaria të bëhet për m' të rrethojës së punuar.</p>	m'	16.00	13.00	208.00 €

8	Sigurimi, transporti dhe shtrirja e dheut kualitativ me hapsirën e kaptazhës në shtresën finale me trashësi min 20 cm. Në llogari hynë edhe mbellja e barit natyral. Llogaria bëhet për m ² të sipërfaqes së punuar.	m ²	24.00	3.00	72.00 €
			Gjithësej II:		928.00 €

III PUNIMET E REZERVUARIT AKUMULUES

III.1 PUNËT E GËRMIMIT

1	Gërmimi i dheut të kategorisë IV të dhe V të dhe formacioneve shkëmbore për hapjen e gropës së rezervuarit akumulues, hapjen e themeleve të veçuara dhe themeleve shiritore me makineri adekuate (eskavator me qeqiç për thyerjen dhe gërmimin e shkëmbinjeve). Llogaria të bëhet për m ³ të dheut dhe formacioneve shkëmbore të gërmuara.	m ³	227.81	1.50	341.72 €
2	Shtirimi i shtresës së zavorit të sepuar me fraksion 0-31.5mm nën pllakën e dyshemes dhe themeleve me trashësi d= 20 cm në gjendje të ngjeshur, këtu hynë edhe ngjeshja me vibrator deri në modulën e kërkuar. Llogaria të bëhet për m ³ .	m ³	9.80	9.00	88.20 €
3	Hapja e kanalit për vendosjen e gypsjellësit furnizues nga burimi (kaptazha) deri te dhoma akumuluese me gjatësi L=30m, këtu hynë edhe hudhja e zhavorit rreth gypit me trashësi 10 cm, njëherit edhe mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar dhe kthimi i terenit në gjendjen e mëparshme. Llogaria të bëhet për m ³ .	m ³	30.00	3.50	105.00 €
4	Gërmimi i dheut të kategorisë III të dhe IV të dhe makineri dhe planifikim me dorë për hapjen e kanalit të rrjetit të ujësjellësit (nga rezervuari i fshatit deri në pjesën e mbetur). Në llogari hynë edhe mbulimi i kanalit pas shtrirjes dhe montimit të gypit duke bërë ngjeshjen e dheut të mbuluar si dhe kthimin e terenit si në gjendjen fillestare. Dimensionet e hapjes dhe mbulimit të kanalit janë; 0.6*0.8* 380 m. Llogaria të bëhet për m ³ të dheut të gërmuar.	m ³	246.24	1.50	369.36 €

5	Transporti, shtrirja dhe montimi i gypit Ø63 mm nga rezervuari akumulues (stacioni pompimit) deri te rezervuari i fshatit (peshorja). Këtu hynë: transporti i gypit nga objekti i Kompanisë së Pastrimit "Pastertia" deri në vendpunishte, shtrirja e gypit, kyqja në sistemin e pompes, kyqja në rezervuarin e fshatit (peshoren), lidhjet e gypave me pjesë fazonike dhe të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor. Në këtë pozicion hynë vetëm shtrirja dhe montimi i gypit. Llogaria bëhet për m' të gypit.	m'	380.00	1.20	456.00 €
6	Testimi mekanik i gypesjërësit në presion provues sipas udhëzimeve të prodhuesve të gypave dhe pjesëve fazonike dhe në pajtim me kushtet teknike të egzekutimit dhe në prezencë të organit mbikqyrës. Llogaria bëhet për m' të gypit të testuar.	m'	670.00	0.30	201.00 €
III.2	PUNËT E BETONIT				
1	Betonimi i themelimeve të veçqara dhe shtatore nga BA I klasës C-30/37 Mpa e armuar me armaturë b500, 8 Ø 12 mm dhe stafave Ø8/20 cm sipas normave dhe kushteve standarde. Në llogari hynë armimi, punët e primit të armaturës dhe të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor. Llogaria të bëhet për m ³ të BA-së së punuar.	m ³	5.96	85.00	506.60 €
2	Sigurimi, transporti dhe betonimi i nënpilakes së dyshemes nga betoni i thjeshtë i klasës C-12/ 15 Mpa me trashësi d= 10 cm. Llogaria të bëhet për m ³ te betonit te punuar ne veper.	m ³	4.90	85.00	416.50 €
3	Sigurimi, transporti dhe betonimi i pilakes së dyshemes nga BA- hidroteknik i klasës C-30/37 Mpa me trashësi d=25 cm e armuar me armaturë B 500 Mpa në dy shtresa me Ø 12/15cm në dy drejtime (armimi i dyfishtë- dy shtresa). Llogaria të bëhet për m ³ të BA-së dhe armaturës si dhe të të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor. Llogaria të bëhet për m ³ te betonit te punuar ne veper.	m ³	12.25	85.00	1,041.25 €

4	<p>Sigurimi, transporti dhe betonimi i mureve të rezervuarit nga BA- hidroteknik i klasë C-30/37 Mpa me trashësi d=20 cm. Armimi të bëhet në dy shtresa me armaturë Q-335 Mpa(Ø 8/15 cm).Këtu hyjnë edhe betonimi i shtyllave me dimensione 20/25 cm, armimi i shtyllave bëhet me armaturë 4 Ø 12 mm dhe stafat Ø 8/15.</p> <p>Llogaria të bëhet për m³ të BA-së të punuar dhe hudhur në veper si dhe të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor.</p>	m ³	15.60	85.00	1,326.00 €
5	<p>Sigurimi, transporti dhe betonimi i pllakes së rezervuarit (sipas detalit) nga BA i klasës C-25/30 Mpa i armuar me armaturë B 500 Mpa, Ø 12/15 cm në dy drejtime dhe armaturës konstruktive Q-335 Mpa.</p> <p>Llogaria të bëhet për m³ të BA-së të punuar dhe hudhur në veper si të të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor.</p>	m ³	5.50	85.00	467.50 €
6	<p>Sigurimi, transporti dhe betonimi i shtyllave dhe trarëve nga BA me beton të klasës C-25/30 Mpa e armuar me armaturë B 500 Mpa, 6Ø12 mm dhe stafave Ø8/15 cm.</p> <p>Llogaria të bëhet për m³ të BA-së të punuar dhe hudhur në veper si të të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor.</p>	m ³	3.30	85.00	280.50 €
7	<p>Sigurimi, transporti dhe betonimi i trotuarit përreth objektit me beton të klasë C-25/30 Mpa dhe armaturës rrjetë Q-335 Mpa. Dimensionet e trotuarit për rreth objektit : 1.0 x 0.15x28 m. Këtu hyjnë edhe shtrirja e zhavorit 0-31.5mm nën shtresën e betonit me trashësi d=10 cm në gjendje të ngjeshur.</p>	m ³	4.50	85.00	382.50 €
III.3	PUNËT E MURATIMIT				
1	<p>Murimi i mureve të jashtme dhe të brendshme me blloka silkapori me trashësi të murit d=20 cm. Lidhja dhe murimi e bllokave të bëhet me ngjitës të gatshëm.</p> <p>Llogaria të bëhet për m³ të murimit .</p>	m ³	18.50	80.00	1,480.00 €

2	Sigurimi , transporti dhe punimi i fasadës së jashtme të shtëpizës me stiropor N3 të presuar me trashësi t= 8cm. Në llogari hynë: Rjeta për stiropor, ngjitësi për stiropor, llajset kendore, tiplat për stiropor etj. Gjithashtu këtu hynë edhe lyerja e mureve të jashtme me fasadë të gatshme të plastifikuar 2.5mm dhe të gjitha nënpozicioneve tjera për kompletim të pozicionit kryesor. Llogaria të bëhet për m ³	m ²	115.00	14.00	1,610.00 €
III.4 PUNËT E HIDROIZOLIMIT					
1	Sigurimi i materialit, transporti dhe punimi i shtresës së hidroizolimit në rezervuarin akumulues me bitulit + kondor me trashësi d= 3mm. Në llogari hynë edhe mbrojtja e shtresës së hidroizolimit pas punimit me zhavor të lumejve. Llogaria të bëhet për m ²	m ²	98.00	7.00	686.00 €
2	Sigurimi dhe montimi i folis plastike (fondalinë) sipas vizatimit. Llogaria të bëhet për m ²	m ²	65.00	2.00	130.00 €
3	Sigurimi i materialit te nevojshem (gatshem) dhe lyerja e pjesës së mbrendshme të rezervuarit akumulues me ngjyrë plastike me trashësi d= 2mm (dy shtresa). Materiali i cili përdoret për lyerje duhet ti plotësoj kushtet dhe standartet teknike për rezervuale te ujit të pijes. Llogaria të bëhet për m ²	m ²	140.00	3.00	420.00 €
4	Sigurimi i materialit, transporti dhe lyerja e mureve të brendshme të shtëpizës dhe tavanit në hapsirën e rezervuarit me material të gatshëm në dy shtresa. Këtu hynë edhe lyerja e mureve dhe tavanit me ngjyre - polikollor të klasës së I-rë në dy shtresa. Llogaria të bëhet për m ² .	m ²	125.00	5.00	625.00 €
III.5 PUNËT E KULMIT					
1	Sigurimi i materialit, transporti dhe punimi i konstruksionit të kulmit të shtëpizës nga druri halor i kategoris së I-rë i mbuluar me llamarinë të plastifikuar e valzuar t=0.7mm ,këtu hyn edhe punimi i strehëve (simsit)nga llamperia e aluminit , murimi i kallkëneve dhe të gjitha nënpozicioneve shtesë për kompletim të pozicionit kryesor. Llogaria të bëhet në sipërfaqen e pjerrt të kulmit në m ² .	m ²	62.00	30.00	1,860.00 €

2	Punimi i konstruksionit të tavanit me pllaka të rigipsit me shtresë të termoizolimit nga leshi i xhamit me trashësi d=5 cm me të gjitha elementet përcjellëse për punim të tavanit me rigips. Llogaria të bëhet për m ²	m ²	45.00	20.00	900.00 €
III.6 PUNËT MONTUESE					
1	Montimi i shkallëve në rezervuar nga materiali antikorezion me gjatësi L=3.5 m , sipas vizatimit.	copë	1.00	150.00	150.00 €
2	Sigurimi i materialit , transporti dhe montimi i olluqeve horizontale dhe vertikale të shtëpizës,sipas vizatimit. Llogaria bëhet për m'	m'	25.00	8.00	200.00 €
3	Sigurimi i materialit, punimi dhe montimi i derës së hymjes në rezervuar nga metali me dimensione 100/205 cm. Llogaria të bëhet për copë.	copë	1.00	300.00	300.00 €
5	Sigurimi i materialit, punimi dhe montimi i dritareve nga materiali i plastikës së klasës së I-rë (me xhama) me dimensione 100/40 cm sipas vizatimit të treguar. Llogaria të bëhet për copë.	copë	2.00	70.00	140.00 €
6	Dezinfektimi i rrjetit të ujësjelësit sipas rregullave dhe kushteve teknike të egzekutimit në prezencë të organit mbikqyrës. Llogaria bëhet për m' të rrjetit të dezinfektuar.	m'	670.00	0.30	201.00 €
7	Sigurimi dhe montimi i gypit me diameter Ø 125mm nga materiali HDPE I klasës së I-rë nga vendi i burimit deri në rezervuar. Llogaria bëhet për m'	m'	35.00	8.00	280.00 €
III.7 PUNËT ELEKTRIKES					
1	Sigurimi, transporti dhe montimi i kablilit "bistek" 4*50mm ² Al. Në llogari hynë kyqja në trafon ekzistuese dhe kuadrin shpërndarës. Llogaria bëhet për m'.	m'	50.00	18.00	900.00 €
2	Sigurimi i materialit të nevojshëm për punimin e instalimit të brendshëm elektrik me elementet përcjellëse sipas detalit. Llogaria bëhet komplet.	kompl.	1.00	150.00	150.00 €
3	Sigurimi i materialit dhe montimi i kuadrit shpërndarës me siguresa, kontaktor,njehsorit elektrik, FID dhe elementet tjera përcjellëse për kompletim dhe funksionim të pompës. Llogaria bëhet komplet.	kompl.	1.00	250.00	250.00 €

4	shtytëse për përrjelljen e ujit nga rezervari akumulues deri në rezervarin e fshatit. Gjatësia e rrjetit është l= 680m dhe disniveleli i rezervuarit të fshatit dhe rezervuarit akumuluese (e cila do të punohet) është h=70 m dhe shtytje të sasis së ujit q= 7.0 l/s. Fuqia e pompes të jetë F= 15 Kë . Montimi i pompës të bëhet me të gjitha pjesët e nevojshme fazonike : shporten thithëse, gypit nga pompa shtytëse deri në rezervuar, manometer, valvulë jokthyese, gypin për zbrazje dhe të gjitha pjesët tjera të nevojshme fazonike për funksionim të pompës. Llogaria të bëhet për copë.	copë	1.00	6500.00	6,500.00 €
				Gjithësej III:	22,764.13 €

A/ REKAPITULIM I UJESJELLËSIT NË BAJNICË

1	PUNIMET NË SHTRATIN E PËRROIT	8,654.65 €
2	PUNIMET E KAPTAZHËS	928.00 €
3	PUNIMET E REZERVUARIT AKUMULUES	22,764.13 €
HUMA TOTALE		32,346.78 €

B/. RRJETI I UJËSJELLËSIT - IVAJË

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
I.	PUNËT GJEODEZIKE				
1	Matjet gjeodezike per riparteritjen e pikave gjeodezike sipas projektit. Llogaria të bëhet për m'	m'	6010.00	0.50	3,005.00 €
				Gjithësej I:	3,005.00 €

II.	PUNËT GËRMIMIT - TOKËSORE
-----	----------------------------------

	Gërmimi i dheut të kategoris së: II-të & III-të (70%) dhe IV-të & V-të (30%) me makineri adekuate për hapjen e kanalit për shtrirjen e gypit të ujësjellësit . Dimensionet e kanalit janë: b=60 cm dhe h=80 cm dhe gjatësi l=6010.00 m. Në llogari hynë edhe gërmi i dheut për hapjen e pusetave të ajrimit, lëshimit dhe pusetave reduktuese.				
1	Llogaria të bëhet për m ³ të dheut gërmuar.	m ³	3929.47		
1.1	- kategoria II-të & III-të 70%	m ³	1964.74	1.20	2,357.68 €
1.2	- kategoria IV-të & V-të 30%	m ³	1964.74	1.50	2,947.10 €
2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë deri në kotën e kërkuar. Llogaria të bëhet për m ² të sipërfaqes së punuar dhe planifikuar.	m ²	3606.00	0.30	1,081.80 €
3	Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar pas montimit dhe testimit të rrjetit të ujësjellësit në shtresa duke bërë ngjeshjen deri në modulën e kërkuar. Llogaria të bëhet për m ³ .	m ³	3340.05	0.50	1,670.03 €
4	Largimi dhe transportimi i materialit të tepërt deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës. Llogaria bëhet për m ³ të materialit të larguar.	m ³	589.42	0.80	471.54 €
5	Sigurim, transporti dhe hudhja e materialit të shkapërderdhur i cili plotëson kushtet për mbulimin e gypit të ujësjellësit për rreth , anash dhe mbi gyp me trashësi min 15 cm në gjendje të ngjeshur. Llogaria bëhet për m ³	m ³	375.63	0.70	262.94 €
6	Sigurimi dhe montimi i shiritit sinjalizues me mbishkrim për ujësjellës në lartësin 20 cm mbi gyp. Llogaria bëhet për m'	m'	6020.00	0.15	903.00 €
